Vendim nr. 324, datë 12.10.2026

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Fiona Papajorgji,	Kryetare
Sandër Beci,	Anëtar
Sonila Bejtja,	Anëtare

në datën 12.10.2026 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 17 (K) 2026 të Regjistrit Themeltar, që u përket:

KËRKUES:	**KLEMENT ÇALA, ELDI ÇALA,** të përfaqësuar nga avokatët Neshat Fana dhe Evjola Shehu, me akt përfaqësimi.
OBJEKTI:	**Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2025-1466, datë 30.09.2025 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.** **Dërgimi i çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë.**
BAZA LIGJORE:	**Nenet 131, pika 1, shkronja "f", dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar (*Ligji Organik i Gjykatës*).**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatoren e çështjes Sonila Bejtja, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese të saj, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesit janë proceduar penalisht nga Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar dhe (*Prokuroria e Posaçme*) për veprat penale "Vjedhja me armë", "Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyese dhe i municionit", "Grupi i strukturuar kriminal" dhe "Kryerja e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal", "Falsifikimi i dokumenteve", më shumë se një herë, të parashikuara nga nenet 140, 278, paragrafi 1, 28, paragrafi 4, 333/a, paragrafi 2, 334, paragrafi 1, dhe 186, paragrafi 2, të Kodit Penal (*KP*). Nga rrethanat ka rezultuar se në datën 09.04.2019, në pistën e aeroportit "Nënë Tereza", Rinas, Tiranë (*aeroporti i Rinasit*) me përdorimin e armëve janë vjedhur një sasi vlerash monetare që i përkisnin tri bankave të nivelit të dytë, për të cilat ishte planifikuar të bëhej eksportimi jashtë vendit.

2. Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (*GJKKO-ja e Shkallës së Parë*), me vendimin nr. 56, datë 05.10.2022, ka vendosur, ndër të tjera, deklarimin fajtor të kërkuesve Klement Çala dhe Eldi Çala për veprat penale për të cilat ishin akuzuar dhe dënimin e tyre përkatësisht me 20 vjet dhe 17 vjet burgim. Sipas asaj gjykate, provohej tej çdo dyshimi të arsyeshëm se kërkuesit dhe të bashkëpandehurit në atë procedim, në bashkëpunim me njëri-tjetrin, kanë planifikuar, kryer përgatitjet e nevojshme, siguruar mjetet e nevojshme dhe realizuar në datën 09.04.2019 vjedhjen me armë të shumave monetare në aeroportin e Rinasit. Në vlerësimin e saj, midis të pandehurve ka pasur marrëveshje të mëparshme, ku kanë përcaktuar mënyrën sesi do të funksiononte ajo marrëveshje dhe rolet që do të kishte secili në realizimin e veprës penale, në drejtim të marrjes së masave paraprake dhe në funksion të arritjes së qëllimit përfundimtar. Plani kriminal për realizimin e vjedhjes ka nisur shumë kohë përpara se ajo të realizohej. Konkretisht, të pandehurit, përfshirë kërkuesit, kanë siguruar dhe kanë përshtatur automjetin me të cilin kanë realizuar vjedhjen, automjetet e tjera me të cilat janë larguar, kanë siguruar mjetet e nevojshme për hapjen e dyerve të emergjencës së perimetrit të aeroportit dhe armët luftarake, kanë studiuar lëvizjet e mjeteve monetare në brendësi të aeroportit, kanë planifikuar kryerjen e vjedhjes dhe e kanë realizuar atë sipas një plani të detajuar.

3. GJKKO-ja e Shkallës së Parë ka arritur në përfundimin se është provuar tej çdo dyshimi të arsyeshëm se vjedhja është kryer me armë nga të pandehurit, ndër ta edhe kërkuesit, në formën e një grupi të strukturuar kriminal. Për fajësinë e kërkuesve ajo gjykatë është bazuar në të dhënat e

përftuara nga: (i) këqyrja e vendit ditën e ngjarjes; (ii) pamjet filmike të administruara; (iii) provat materiale të sekuestruara; (iv) dokumentacioni i administruar nga bankat e nivelit të dytë; (v) aktet e ekspertimit tekniko-balistik; (vi) gjurmët papilare; (vii) përfshirja në të njëjtën veprimtari kriminale nëpërmjet njohjeve shoqërore dhe lidhjeve fisnore (ndër të cilat njohja e kërkuesit Klement Çala, i dënuar me vendimin nr.109, datë 14.11.2017 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda për veprat penale të kryera në Greqi në formën e një grupi të strukturuar kriminal, me shtetasin A.M., pjesëmarrës në vjedhje, i cili kishte humbur jetën gjatë shkëmbimit të zjarrit me forcat e policisë, të cilët kanë ndarë të njëjtën qeli në burgun Trikala, e nga ku më pas janë arratisur; (viii) komunikimet telefonike mes të pandehurve dhe logimi i tyre në të njëjtën antenë në ditë të caktuara përpara ngjarjes; (ix) fotografitë e gjetura në telefonin e shtetasit R.H. ku janë evidentuar foto me kërkuesin Eldi Çala dhe shtetasin A.M, pamje të aeroportit, të rrethimit të tij, të pistës së avionëve, vetëm 4 ditë përpara ngjarjes, si dhe të ceremonisë mortore të shtetasit A.M.; (x) komunikimet e shqetësuara pas ngjarjes të shtetases E.Ç.(nëna e kërkuesve) me të pandehurit R.S dhe S.Ç., të cilët, sipas saj, ishin të angazhuar intensivisht për shmangien e problemeve pas ngjarjes në të cilën ata ishin përfshirë, komunikimi ambiental i datës 20.04.2019 nga ku ka rezultuar se të pandehurit në ambientet e paraburgimit kanë biseduar për arrestimin e tyre, në kuptimin se ata e dinin shkakun dhe përpiqeshin për fshehjen e tij dhe për shmangien e pasojave të rënda të mundshme; (xi) sekuestrimi i dokumenteve leje drejtim automjeti dhe kartë identiteti të shtetit grek me emra të tjerë e me fotot e kërkuesve, të falsifikuara, sipas aktit të ekspertimit teknik të datës 06.04.2020; (xii) sekuestrimi i armëve dhe i municioneve luftarake, si dhe i shumës prej 133.960 eurosh në banesën e kërkuesve. Kundër këtij vendimi kanë paraqitur ankim, ndër të tjerë, edhe kërkuesit.

4. Vendimi i mësipërm është lënë në fuqi nga Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (*GJKKO-ja e Apelit*) me vendimin nr. 34 (87-2023-173), datë 26.07.2023. GJKKO-ja e Apelit ka vlerësuar se veprimet e të pandehurve, ndër të cilët edhe kërkuesit, për sigurimin e mjeteve prerëse të rrethimit të aeroportit, mbulimin e tyre për të mos u identifikuar, sigurimin e armëve dhe mjeteve të qarkullimit, koordinimin e veprimeve të zhvendosjes, ndërhyrjes në sigurimin e hedhjes në dorë/marrjes haptazi në bordin e avionit të ndodhur në pistën e aeroportit në datën 09.04.2019 të pasurisë së luajtshme valutë e huaj për të mos e kthyer më, shoqëruar me mbajtjen e armëve dhe të municioneve luftarake dhe me përdorimin

e tyre, janë veprime që përputhen me veprën penale të vjedhjes së pasurisë, shoqëruar me mbajtjen e armëve dhe të municioneve luftarake ose me përdorimin e tyre, që dënohet me burgim nga dhjetë gjer në njëzet vjet, të parashikuar nga neni 140 i KP-së. Sipas GJKKO-së së Apelit, verifikimi si i vërtetë i faktit historik të pretenduar nga prokurori ndaj të pandehurve, pra parashtrimi i përmbledhur i rrethanave të faktit dhe i provave mbi të cilat bazohet vendimi, është shkaku kryesor i rrëzimit të pretendimeve dhe të deduksioneve të ngritura nga kërkuesit e pandehur apo nga mbrojtja e tyre. Për më tepër, meqenëse në këtë gjykim nuk është pretenduar ndonjë alibi nga kërkuesit e pandehur dhe nuk është marrë ose verifikuar ndonjë provë e kundërt gjatë shqyrtimit gjyqësor, GJKKO-ja e Apelit ka vlerësuar se nuk qëndron detyrimi për të parashtruar arsyet se përse gjykata i ka quajtur të papranueshme provat e kundërta. Nga ana tjetër, GJKKO-ja e Apelit ka vlerësuar se arsyetimet e secilit prej vendimeve të gjykatave të faktit janë komplementarë të njëri-tjetrit, pasi në to gjenden parashtrimi i përmbledhur i rrethanave të faktit dhe provat mbi të cilat bazohet vendimi, fajësia e secilit prej të pandehurve, cilësimi ligjor i veprimeve që u ngarkohen, dënimi i caktuar, urdhërimi i konfiskimit, i asgjësimit dhe kthimit të sendeve materiale, ndërkohë që asnjë prej pretendimeve të kërkuesve të pandehur dhe të mbrojtësve të tyre, nuk është i bazuar. Kundër këtij vendimi kanë ushtruar rekurs të pandehurit, ndër ta edhe kërkuesit.

5. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2025-1466, datë 30.09.2025, ka vendosur mospranimin e rekurseve të të pandehurve, ndër ta edhe kërkuesit, me arsyetimin se nuk përmbajnë asnjë nga shkaqet e parashikuara nga neni 432/1 i Kodit të Procedurës Penale (*KPP*). Sipas Gjykatës së Lartë, është i drejtë përfundimi i arritur nga GJKKO-ja e Apelit se vendimi i GJKKO-së së Shkallës së Parë ka përmbushur elementet e vendimit në mënyrë specifike lidhur me parashtrimin e arsyeve për mospranimin e provave të kundërta. Gjykata e Lartë ka arsyetuar se vendimmarrja e gjykatave të faktit është në zbatim të drejtë të ligjit penal dhe se gjykata e apelit u ka dhënë përgjigje të argumentuara dhe i ka trajtuar të gjitha pretendimet e parashtruara në ankimet e të gjykuarve, përfshirë kërkuesit. Në vlerësimin e saj, është vërtetuar tej çdo dyshimi të arsyeshëm, se kanë qenë të pandehurit, përfshirë kërkuesit, që në bashkëpunim me njëri-tjetrin, në formën e grupit të strukturuar kriminal, kanë planifikuar dhe kryer përgatitjet e nevojshme, kanë siguruar mjetet e nevojshme dhe që kanë realizuar në datën 09.04.2019 vjedhjen me armë të shumave monetare në aeroportin e Rinasit. Gjykatat kanë analizuar të gjitha elementet e secilës vepër penale të konsumuar nga secili i gjykuar, duke arsyetuar në mënyrë specifike çdo veprim të

kryer, në zbërthim të provave të marra në tërësinë e tyre në përputhje me nenin 152 të KPP-së, në mënyrë që të ndodhej përpara qartësisë së krijimit të bindjes përtej çdo dyshimi të arsyeshëm. Si përfundim, ajo gjykatë ka vlerësuar se shkaqet e parashtruara në rekurs nuk referojnë shkelje të ligjit penal material e procedural, me rëndësi për njësimin ose zhvillimin e praktikës gjyqësore, nuk konstatohen shkelje ose zbatim i gabuar i ligjit penal procedural me pasojë pavlefshmërinë e vendimit ose të akteve, ose papërdorshmërinë e provave, si dhe nuk rezulton që vendimi i rekursuar të jetë në kundërshtim me praktikën e Kolegjit Penal ose të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

6. Në datën 25.05.2026 kërkuesit i janë drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, sipas objektit të tij, i cili, pasi është plotësuar sipas kërkesave të Ligjit Organik të Gjykatës, është regjistruar më 17.06.2026. Në lidhje me afatin për shqyrtimin paraprak të çështjes, të përcaktuar në nenin 47, pika 1, të Ligjit Organik të Gjykatës, bazuar në nenet 15, pika 2 dhe 21, pika 1, të Rregullores për Procedurat Gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese, në këtë afat nuk llogaritet periudha e lejes vjetore të anëtarëve të Gjykatës, sipas nenit 18, pika 1, shkronja "b", të po këtij ligji.

II

Pretendimet e kërkuesve

7. ***Kërkuesit,*** në mënyrë të përmbledhur, kanë pretenduar se u janë cenuar:

7.1. *E drejta për proces të rregullt ligjor në drejtim të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor,* pasi gjykatat e posaçme dhe Gjykata e Lartë nuk kanë arsyetuar për rolin dhe kontributin e secilit prej të pandehurve në "grupin e strukturuar kriminal", si dhe vendimmarrjet e tyre bien ndesh me provat, sepse kërkuesit nuk kanë pasur asnjë rol dhe nuk janë ekzekutorë të vjedhjes.

7.2. *Parimi i prezumimit të pafajësisë,* pasi gjatë hetimit dhe gjykimit nuk është provuar që kërkuesit të kenë qenë pjesëmarrës në vjedhjen e ndodhur në aeroportin e Rinasit. Kërkuesit nuk kishin dijeni se mjeti të cilit ata i kanë bërë servis do të përdorej për të kryer vjedhjen. Po kështu, lidhjet shoqërore dhe fisnore të një pjese të të pandehurve nuk provojnë bashkëpunimin e tyre, ndërkohë nuk është provuar që kërkuesit të kenë rekrutuar ndonjë nga të pandehurit. Një pjesë e mirë e të pandehurve banojnë në një rreze

të afërt me njëri-tjetrin prandaj logohen në të njëjtën antenë. Komunikimi telefonik i nënës së kërkuesve me njërin nga të pandehurit disa orë pas ngjarjes dhe interesimi i saj për personin e vrarë gjatë shkëmbimit të zjarrit është keqinterpretuar nga gjykatat, të cilat kanë pasur për qëllim implikimin e paracaktuar të kërkuesve. Ndonëse u është sekuestruar një shumë e madhe lekësh, kërkuesve nuk u është gjetur asnjë kartëmonedhë e vjedhur. Vendimi nr.109, datë 14.11.2017 i Gjykatës së Shkallës së parë për Krime të Rënda nuk është përfundimtar dhe është keqpërdorur nga gjykatat. Prokuroria e Posaçme ka ushtruar dhunë psikologjike ndaj bashkëpunëtorit të drejtësisë për të realizuar dëshminë e tij. Kërkuesi Klement Çala mban përgjegjësi për armët e gjetura në banesën e tij, por jo për armët e gjetura në vendin e ngjarjes. GJKKO-ja e Apelit ka përcaktuar rolet e të pandehurve nisur nga bindja e brendshme, por jo nga provat.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për kriteret e pranueshmërisë së kërkesës

8. Gjykimi kushtetues mund të vihet në lëvizje vetëm nëse përmbushen kriteret paraprake të pranueshmërisë së kërkesës, të parashikuara nga Kushtetuta dhe Ligji Organik i Gjykatës. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja "f", dhe 134, pikat 1, shkronja "i", dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të Ligjit Organik të Gjykatës, çdo individ mund t'i drejtohet Gjykatës për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë edhe kriteret e nenit 71/a të Ligjit Organik të Gjykatës, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuara në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

9. Kriteret paraprake të pranueshmërisë janë të natyrës kumulative, ndaj, në këtë këndvështrim, mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuesi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues. Kolegji evidenton se gjatë shqyrtimit paraprak të çështjes vlerësohet plotësimi i një ose më shumë kritereve të pranueshmërisë, në varësi të elementeve dhe veçantive të çështjes konkrete, me qëllim që vendimi të jetë sa më i qartë dhe shterues për

kërkuesin. Thënë ndryshe, mund të ndodhë që në shqyrtimin paraprak të një çështjeje të verifikohet mospërmbushja edhe vetëm e një kriteri, duke sjellë si pasojë moskalimin e saj në seancë plenare *(shih vendimin nr. 112, datë 30.04.2025 të Mbledhjes së Gjyqtarëve)*.

10. Në çështjen konkrete, Kolegji vlerëson të ndalet në analizën e kriterit *ratione materiae.* Në këtë drejtim, Kolegji konstaton se pretendimet e kërkuesve lidhen me cenimin e procesit të rregullt ligjor në drejtim të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor dhe parimit të prezumimit të pafajësisë. Nisur nga thelbi i pretendimeve, se vendimet e gjykatave të faktit dhe të Gjykatës së Lartë janë marrë janë marrë në shkelje të parimeve kushtetuese të procesit gjyqësor penal, si prezumimi i pafajësisë dhe vendimi i fajësisë jepet përtej çdo dyshimi të arsyeshëm, Kolegji çmon që ato të analizohen në vijim së bashku për bazueshmërinë e tyre.

B. Për pretendimin e cenimit të parimit të prezumimit të pafajësisë të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor

11. Kërkuesit, në mënyrë të përmbledhur, kanë pretenduar se vendimet e gjykatave të posaçme dhe të Gjykatës së Lartë janë marrë në mungesë të provave, pasi nuk është provuar që kërkuesit të kenë qenë pjesëmarrës në vjedhjen e ndodhur në aeroportin e Rinasit. Sipas kërkuesve, lidhjet shoqërore dhe fisnore mes disa prej të pandehurve, ose logimi i tyre në të njëjtën antenë të telefonisë celulare nuk mund të përbëjë provë për bashkëpunimin e tyre në një grup të strukturuar kriminal. Po kështu, gjykatat e posaçme kanë keqinterpretuar vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda që e ka dënuar për disa vepra penale të ndodhura në Greqi, si dhe nuk kanë arsyetuar për rolin dhe kontributin e secilit prej të pandehurve në "grupin e strukturuar kriminal".

12. Kushtetuta në nenin 30 të saj përcakton se kushdo quhet i pafajshëm, përderisa nuk i është provuar fajësia me vendim gjyqësor të formës së prerë. Ky parim kushtetues ka gjetur pasqyrim edhe në nenin 4 të KPP-së, i cili përcakton gjithashtu se çdo dyshim për akuzën çmohet në favor të të pandehurit. Në jurisprudencën kushtetuese është pohuar se sipas këtij parimi, në gjykimin penal, barra e provës i takon palës akuzuese, çdo dyshim duhet të shkojë në favor të të pandehurit dhe gjykatat e zakonshme duhet ta mbështesin vendimin në prova të drejtpërdrejta dhe të tërthorta (*shih vendimet nr. 63, datë 20.11.2023; nr. 10, datë 12.04.2022; nr. 68, datë 14.11.2016 të Gjykatës Kushtetuese*). Sipas këtij parimi, asnjë dënim penal nuk mund të jepet ndaj një të

pandehuri pa u provuar fajësia e tij përtej çdo dyshimi të arsyeshëm (*shih vendimet nr. 8, datë 20.02.2024; nr. 12, datë 24.04.2018 të Gjykatës Kushtetuese*).

13. Gjykata ka theksuar gjithashtu se arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Funksioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë. Vendimi duhet të mbështetet vetëm mbi faktet që janë paraqitur gjatë procesit gjyqësor dhe duhet të përmbajë bazën ligjore, analizën e provave dhe mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes. Arsyetimi duhet domosdoshmërisht të plotësojë kriteret minimale ligjore të përcaktuara dhe të mos ketë të meta të tilla serioze që cenojnë standardin e vendimit gjyqësor të arsyetuar *(shih vendimet nr. 70, datë 15.10.2024; nr. 21, datë 26.09.2022; nr. 67, datë 10.11.2017 të Gjykatës Kushtetuese)*.

14. Gjithashtu, Gjykata në jurisprudencën e saj është shprehur se interpretimi i ligjit është atribut i organeve që e zbatojnë atë dhe, nisur nga ky parim, sqarimi i kuptimit ose interpretimi i çdo dispozite ligjore të zbatueshme gjatë shqyrtimit të një çështjeje të caktuar është në kompetencë të gjykatave të sistemit të zakonshëm gjyqësor *(shih vendimet nr. 19, datë 07.07.2022; nr. 2, datë 11.02.2021; nr. 1, datë 20.01.2012 të Gjykatës Kushtetuese*). Megjithatë, kur gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, përmes interpretimit dhe zbatimit të ligjit në një çështje konkrete, cenojnë parimet, standardet ose të drejtat kushtetuese, atëherë interpretimi i ligjit i nënshtrohet kontrollit kushtetues. Në këto raste, Gjykata bën një vlerësim të natyrës kushtetuese, të dallueshëm nga ai i gjykatave të juridiksionit të zakonshëm (*shih vendimet nr. 19, datë 07.07.2022; nr. 3, datë 23.02.2016; nr. 62, datë 23.09.2015 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata nuk vepron si shkallë e katërt gjykimi dhe për këtë arsye vendimet e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm nuk vihen në dyshim, përveç rasteve kur gjetjet e tyre mund të konsiderohen si arbitrare ose haptazi të paarsyeshme. Thënë ndryshe, ajo vepron në rastin kur gabimi ligjor ose faktik nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm është aq i dukshëm, sa një gjykatë e arsyeshme nuk mund ta kishte bërë ndonjëherë ose i tillë që gjykimin e bën të padrejtë (*shih vendimet nr. 14, datë 07.03.2024; nr. 9, datë 27.02.2024; nr. 33, datë 14.11.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

15. Mbi bazën e këtyre standardeve, sikurse u parashtrua në rrethanat e çështjes, Kolegji vëren se gjykata e shkallës së parë fillimisht ka identifikuar provat, prej të cilave ka nxjerrë përfundimin për fajësinë dhe dënimin e kërkuesve. Për fajësinë e kërkuesve ajo gjykatë është bazuar në të dhënat e përftuara nga këqyrja e vendit të ngjarjes, pamjet filmike të administruara, provat

materiale të sekuestruara, dokumentacioni i administruar nga bankat e nivelit të dytë, aktet e ekspertimit tekniko-balistik, përfshirja në të njëjtën veprimtari kriminale nëpërmjet njohjesh shoqërore dhe lidhjesh fisnore, komunikimet telefonike dhe logimi i tyre në të njëjtën antenë në ditë të caktuara përpara ngjarjes, fotografitë e gjetura në telefonin e shtetasit R.H, ku janë evidentuar foto me kërkuesin Eldi Çala dhe shtetasin A.M, pamje të aeroportit, të rrethimit të tij, të pistës së avionëve, vetëm 4 ditë përpara ngjarjes dhe të ceremonisë mortore të shtetasit A.M., komunikimet e shqetësuara pas ngjarjes të nënës së kërkuesve me të pandehurit R.S dhe S.Ç., të cilët, sipas saj, ishin të angazhuar intensivisht për shmangien e problemeve pas ngjarjes në të cilën ata ishin përfshirë, komunikimi ambiental i datës 20.04.2019, nga ku ka rezultuar se të pandehurit në ambientet e paraburgimit kanë biseduar për gjendjen e tyre të arrestimit, në kuptimin se ata e dinin shkakun dhe përpiqeshin për fshehjen e tij, dhe për shmangien e pasojave të rënda të mundshme, sekuestrimi i dokumenteve leje drejtim automjeti dhe kartë identiteti të shtetit grek me emra të tjerë e me fotot e kërkuesve, të falsifikuara, sipas aktit të ekspertimit teknik të datës 06.04.2020, si dhe sekuestrimi i armëve dhe municioneve luftarake dhe i shumës prej 133.960 eurosh në banesën e kërkuesve. Është provuar plotësisht fakti se kërkuesit janë pjesë e një grupi të strukturuar kriminal, të cilët në bashkëpunim me të pandehurit e tjerë kanë kryer me armë vjedhjen e vlerave monetare në aeroportin e Rinasit. Në përfundim, ajo gjykatë ka arsyetuar se kërkuesit kanë kryer veprat penale për të cilat janë akuzuar, pasi është provuar tej çdo dyshimi të arsyeshëm se ata janë pjesë e një grupi të strukturuar kriminal, të cilët, në bashkëpunim me të pandehurit e tjerë, kanë kryer me armë vjedhjen e vlerave monetare në aeroportin e Rinasit.

16. Vendimi i gjykatës së shkallës së parë është lënë në fuqi nga gjykata e apelit, e cila, në të njëjtën linjë arsyetimi, ka theksuar se veprimet e kërkuesve dhe të të pandehurve të tjerë, si sigurimi i mjeteve prerëse të rrethimit të aeroportit, mbulimi i tyre për të mos u identifikuar, sigurimi i armëve dhe i mjeteve të qarkullimit, koordinimi i veprimeve të zhvendosjes dhe ndërhyrja në sigurimin e hedhjes në dorë/marrjes haptazi në bordin e avionit të ndodhur në pistën e aeroportit të pasurisë së luajtshme valutë e huaj për të mos e kthyer më, shoqëruar me mbajtjen dhe përdorimin e armëve dhe të municioneve luftarake, janë veprime që përputhen me veprën penale të vjedhjes së pasurisë e shoqëruar me mbajtjen e armëve dhe të municioneve luftarake, ose me përdorimin e tyre. Sipas GJKKO-së së Apelit, nuk është pretenduar asnjë alibi substanciale e të pandehurve dhe, për këtë shkak, asnjë provë e kundërt nuk është marrë ose verifikuar në shqyrtimin

gjyqësor. Pra, nuk qëndron detyrimi për të parashtruar arsyet, për të cilat gjykata i quan të papranueshme provat e kundërta.

17. Ndërsa Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkuesve, me arsyetimin se nga shqyrtimi i akteve të dosjes gjyqësore gjykatat më të ulëta kanë arritur në përfundimin se të gjykuarit, përfshirë kërkuesit, tej çdo dyshimi të arsyeshëm, kanë konsumuar plotësisht elementet e veprave penale, për të cilat janë akuzuar. Sipas Gjykatës së Lartë, gjykatat e faktit kanë analizuar të gjitha elementet e secilës vepër penale të konsumuar, duke arsyetuar në mënyrë specifike çdo veprim të kryer, në zbërthim të provave të marra në tërësinë e tyre, në përputhje me nenin 152 të KPP-së, në mënyrë që të ndodhej përpara qartësisë së krijimit të bindjes përtej çdo dyshimi të arsyeshëm. Gjykata e Lartë ka vlerësuar se cilësimi ligjor i faktit penal që iu atribuohet kërkuesve, provueshmëria, mospranimi i provave të kundërta, masa e dënimit të caktuar ndaj tyre nga gjykata e apelit janë marrë në përputhje me ligjin penal material dhe procedural. Sipas Gjykatës së Lartë nuk konstatohen shkelje ose zbatim i gabuar i ligjit penal procedural me pasojë pavlefshmërinë e vendimit ose të akteve, ose papërdorshmërinë e provave, si dhe nuk rezulton që vendimi i rekursuar të jetë në kundërshtim me praktikën e Kolegjit Penal ose të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

18. Në analizë të sa më sipër, Kolegji vlerëson se gjykatat i kanë deklaruar fajtorë kërkuesit, pasi kanë shqyrtuar e vlerësuar një tërësi provash, si përgjimi ambiental, përgjimi i komunikimeve telefonike, vendndodhja e qelizave telefonike, pamjet filmike të administruara, provat materiale të sekuestruara, armët dhe shumat e lekëve të sekuestruara, të cilat janë analizuar në tërësi dhe në harmoni me njëra-tjetrën, ndaj nuk rezulton që ato të kenë arritur në një konkluzion *a priori* për fajësinë e tyre. Vendimet e gjykatave janë mbështetur vetëm në faktet e paraqitura gjatë procesit gjyqësor dhe përmbajnë bazën ligjore, analizën e provave, mënyrën e zgjidhjes së çështjes, konkretisht deklarimin e kërkuesve fajtorë për veprat penale, për të cilat janë akuzuar. Ato gjykata nuk e kanë nisur procesin gjyqësor me bindjen se kërkuesit kanë qenë fajtorë dhe as e kanë zhvendosur barrën e provës nga prokurori tek ata. Po kështu, Gjykata e Lartë ka dhënë mjaftueshëm argumente se përse shkaqet e ngritura në rekurs janë të papranueshme, në kushtet kur nuk ka konstatuar zbatim të gabuar të ligjit procedural ose material penal nga gjykatat më të ulëta dhe për sa kohë pretendimet e kërkuesve lidheshin me vlerësimin e provave. Arsyetimi i të tria gjykatave nuk përmban gabime faktike ose ligjore të dukshme që t'i bëjë ato arbitrare.

19. Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se pretendimi i kërkuesve për cenimin e parimit të prezumimit të pafajësisë të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit është haptazi i pabazuar.

20. Në përfundim, Kolegji çmon se ankimi kushtetues individual nuk plotëson kriteret ligjore paraprake për pranimin e tij për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pikat 1 dhe 2, shkronja "e", të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.